



PROCESIMI I PAGAVE NË UNIVERSITETIN “UKSHIN HOTI” PRIZREN

1
MARS 2016

(HYRJE)

- Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Kosovës, nga kategoria **PAGA DHE MEDITJE**. Nga këto burime financiare paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet tjera për personelin akademik dhe jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune, si dhe puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të rregullt dhe të angazhuar në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”
- Lartësia e të ardhurave personale caktohen në bazë koeficienteve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat sipas kodimit unik për tërë arsimin në Kosovë.

DISPOZITAT E VEÇANTA

Shërbimi për financa i Universitetit e bënë përlogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit për angazhimin e personelit akademik për çdo vit akademik

Me personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prizrenit, në pajtim me dispozitat ligjore lidhet kontratë pune:

Me normë te plotë,
Me gjysmë normë dhe
Me honorarë.



PERSONELI AKADEMIK

Për personelin akademik të punësuar në Universitetet përcaktohet norma javore e orëve dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik si në vijim:

Kompensimi i personelit akademik me normë të plotë të punës

a) Titulli	Orë/javë	Vlera monetare (€) Euro
Profesorët e rregullt	6 orë/javë	1429.54
Profesorët e asocuar	6 orë/javë	1283.34
Profesorët asistent	6 orë/javë	1137.14
Ligjëruesit	6 orë/javë	990.94
Lektorët	10 orë/javë	844.73
Asistentët	10 orë/javë	772.50



KOMPENSIMI FUNKSIONAL SIPAS POSTEVE UDHËHEQËSE (BRUTO €)

Pozita-Funksioni	Paga bazë:	Shtesa:
Rektor	Në bazë të thirrjes akademike	500.00
Prorektor	Në bazë të thirrjes akademike	400.00
Kryesues i Këshillit Drejtues	0.00	250.00
Zv. kryesues i Këshillit Drejtues	0.00	200.00
Anëtar i Këshillit Drejtues	Në bazë të thirrjes akademike	200.00
Dekan	Në bazë të thirrjes akademike	200.00
Prodekan	Në bazë të thirrjes akademike	150.00
Shef i departamentit (degës)	Në bazë të thirrjes akademike	50.00



KOMPENSIMI (BRUTO €) PËR ORËT E MBAJTURA MBI NORMË DHE HONORARË

Për profesorët e Universitetit (Prof. i rregullt, Prof. asoc. Prof. ass.)..... 25 € /orë

Për profesorët nga Universitetet e rajonit/ndërkombëtare (Por jo edhe profesorëve nga Universitet e shteteve fqinje).
..... 40 € /orë

Për ligjërues, lektor, asistent,..... 13 € /orë

Për profesorët jashtë UPZ-së, por me tituj të barasvlershëm..... 25 € /ore

Rektori, Prorektori, Anëtari i Këshillit Drejtues, Dekani dhe Prodekani, kanë për obligim të mbajnë **3** orë të normës së paraparë sipas thirrjes që kanë, ndërsa **6** orë i paguhen në kuadër të mbi normës.

Kompensimi për mësim-honorari jepet maksimalisht për nëntë (9) muaj gjatë vitit akademik. Respektivisht kontratat për mësim honorar dhe mbi normë mund të lidhën prej datës 1 Tetor deri më 30 Janar dhe 15 Shkurt deri më 15 Qershor të të njëjtit vit akademik. Në raste të veçanta me kërkesë të dekanit dhe vendim të Rektorit kontratat për mësim honorar dhe mbi normë mund të lidhën prej datës 1 Tetor deri më 30 Qershor të të njëjtit vit akademik.



NORMA E ORËVE MBI NORMË

Personeli akademik i Universitetit në marrëdhënie të rregullt (Prof. Dr; Prof Asoc. Dr; Prof Ass. Dr; dhe Ligjërues) që janë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet mund të mbajnë deri në **5** orë mbi normë në javë.

Lektori, asistenti që janë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet mund të mbajnë deri në **8** orë mbi normë në javë.

PERSONELI AKADEMIK QË NUK KA MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE NË UNIVERSITET (STAFI I ANGAZHUAR)

- Angazhimi i personelit akademik me orë mbi normë dhe me honorar në Universitet bëhet në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit me propozim të njësisë akademike, më së voni deri me 30 shtator të vitit vijues.
- Personeli akademik që nuk ka marrëdhënie të rregullt pune në Universitet por që angazhohet nga jashtë universitetit, mund të mbajë deri në **6** orë ligjërata në javë ndërsa asistenti deri në 8 orë ushtrime në javë. Përgjashtimisht nga kjo pikë për ligjëruesit e angazhuar në gjuhën Turke dhe Boshnjake, mund të mbajnë deri në 8 orë ligjërata në javë.



PROCESIMI I PAGAVE

Universiteti i Prizrenit, operon si vijë buxhetore ne kuader te MASHT.

Procedimi I pageve realizohet komform rregulloreve te Universitetit, por gjithmone duke respektuar percaktimet buxhetore te ndara nga MASHT.

Stafi I angazhuar procedohet me liste te veqante ne fillim te semestrit nga ana e njesive akademike.

Ne ate liste specifikohe:Grada shkencore, thirrja akademike, fondi I oreve ne total si ushtrime dhe ligjerata etj.Ne baze te listes se sjellur behet edhe perpilimi i Kontratave te Punes.Pas nenshkrimit te kontratave nga punedhenesi dhe punemarresi, filloj per pergaditjen e dosjeve per pagese.



Vërejte:

MAP na ka detyruar nga përvoja e kaluar që orët akademike të shëndrrojmë në ore të shërbimit civil. Për këtë problem ne kemi mbajtur një mbledhje tre orësh vitin e kaluar në MAP dhe është sugjeruar që të gjitha orët të shëndrrohen në orë të SHCK-së.

Nga ky fakte jemi detyruar që çdo herë edhe të angazhuarit të fusim në listë të rregullt të pagave dhe orët e tyre akademike të kontraktuara t' i shëndrrojmë në orë të Shërbimit Civil.

Në fillim është menduar që edhe Upz të veprojnë me kompensime për të angazhuarit një lloj si UP, mirpo ne parimisht jemi dy institucione krejtësisht të ndryshme sa i përket buxhetimit.

UP-(Organizatë Buxhetore)-që i shfrytëzon të hyrat vetanake dhe më këto të hyra paguan stafin akademik të angazhuar si (UNI KONTRAKTOR) nga kategoria të hyrat vetanake.

Upz-Vije buxhetore nën Ministrinë e Arsimit (nuk lejohet shfrytëzimi i të hyrave vetanake) dhe nuk mund të bëjë pagesa nga kjo kategori.



SHENDRRIMI I ORËVE AKD NË SHCK

Nr.rend.:	Thirrja:	Paga sipas kontratës:	Paga sipas thirrjes:	Paga sipas KD:	% e pagës:	Norma SHCK	Paga e re:
1	Ligjërues	312,00	792,75	990,94	31,49	12,59	312,00
2	Prof.i asocuar	500,00	1.026,67	1.283,34	38,96	15,58	500,00
3	Prof.asistent	600,00	909,71	1.137,14	52,76	21,11	600,00
4	Prof.i rregullt	600,00	1.143,63	1.429,54	41,97	16,79	600,00
5	Asistent	208,00	618,00	772,50	26,93	10,77	208,00
				0,00		0,00	0,00

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM PER REALIZIMIN E SE DREJTES SE PAGES NE UPZ.

- 1.Kopjen e letërnjoftimit në të dy anët**
- 2.Kopjen e kartelës se bankës.**
- 3.Certifikaten e numrit fiskal që nxirret në
Administratën Tatimore të Kosovës.**

Krahasimi I pagave behet cdo muaj nga zyrtari per paga,cdo gabim teknik i leshuar evitohet menjeher ne muajin vijues.

Shembull:

Nr rend	Emri dhe mbiemri	Paga bruto	Oret	ORET NE KONTRATE	LISTA TETOR	PAGA NENTOR	PAGA DHJETOR	PAGA JANAR	DUHET	KA MARRË	DIFERENCA	
1	Abdurrezak Ukallo	416,00	8,00	16,79	17,00	0,00	421,15	837,15	421,15	1.664,00	1.679,45	15,45
2	Adelina Rakaj	312,00	6,00	16,16	16,00	309,00	309,00	309,00	309,00	1.248,00	1.236,00	-12,00
3	Adem Zejnullahu	600,00	4,00	11,19	21,00	393,12	393,12	393,12	393,12	2.400,00	1.572,48	-827,52
4	Adem Zogjani	400,00	4,00	14,07	14,00	398,00	398,00	398,00	398,00	1.600,00	1.592,00	-8,00

JU FALEMINDERIT

TAULAND THAQI-ZYRTAR PËR PAGA

4/28/16

14